PROGRAMI VJETOR GLOBAL I PEDAGOGUT TË SHKOLLËS

për vitin shkollor 2026–2027

I. PUNA ME NXËNËSIT

Pedagogu vepron kryesisht në drejtim të krijimit të praktikës efektive edukative dhe zhvillimit të teknikave dhe metodave për përmirësimin e procesit të të nxënit. Duke respektuar nevojat dhe karakteristikat individuale të nxënësve, pedagogu i këshillon, i edukon dhe i ndihmon që të përmirësojnë mënyrën e të nxënit dhe sjelljen. Praktikon metoda dhe mjete për punë edukative, zbaton modele bashkëkohore të udhëheqjes pedagogjike në situata të ndryshme edukative dhe realizon punë këshilldhënëse-edukative për tejkalimin e shkaqeve të problemeve në të nxënë dhe në sjellje. Gjithashtu, i ndihmon nxënësit në zgjedhjen e aktiviteteve jashtëmësimore në përputhje me interesat e tyre.

1.1. Mbështetja e nxënësve në të nxënë

- Përdorimi i metodave dhe instrumenteve të ndryshme për hulumtimin e gatishmërisë për përfshirjen e nxënësve në nivelin përkatës të arsimit.
- Përgatitja e dokumenteve (plane, procedura, udhëzime, rekomandime) për identifikimin e nevojave arsimore të nxënësve dhe për sigurimin e mbështetjes adekuate.
- Organizimi dhe realizimi i llojeve të ndryshme të punës individuale dhe grupore me nxënësit për çështje që lidhen me të nxënit, suksesin dhe sistemin e vlerave.
- Mbledhja e të dhënave për shkaqet e dështimit përmes hulumtimeve, intervistave dhe diskutimeve.
- Informimi i prindërve, mësimdhënësve dhe nxënësve dhe dhënia e rekomandimeve adekuate.
- Përdorimi i metodave dhe instrumenteve të ndryshme për identifikimin e nevojave për mbështetje në të nxënë dhe vetëvlerësim.
- Planifikimi dhe dhënia e mbështetjes së drejtpërdrejtë për nxënësit në të nxënë.
- Identifikimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.
- Bashkëpunimi me kolegët nga ekipi inkluziv në shkollë.

1.2. Përcjellja dhe mbështetja e zhvillimit të nxënësve

- Mbështetja e nxënësit sa herë që i nevojitet (nxënësit informohen për mundësitë e konsultimit).
- Mbledhja e informacioneve për punën dhe sjelljen e nxënësve përmes përcjelljes së mësimit.
- Ndihma e nxënësve që të përballen me situata krize (sëmundje, vdekje, divorc, dhunë në familje e të ngjashme).
- Informimi i nxënësve për aktivitetet jashtëmësimore në shkollë.
- Ndërhyrja në rast të sjelljes së papërshtatshme të nxënësve.
- Këshillimi dhe përcjellja e nxënësve përmes stimulimit, parandalimit, bindjes, sigurimit të mbështetjes dhe bisedës.
- Pjesëmarrja dhe dhënia e mbështetjes në identifikimin e dëshirave dhe interesave specifike të nxënësve për realizimin e aktiviteteve të lira dhe jashtëmësimore.

II. PUNA ME MËSIMDHËNËSIT

Pedagogu i ndihmon mësimdhënësit në planifikimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore (duke marrë parasysh planifikimet e mëparshme dhe rezultatet e arritjeve), realizimin e mësimit duke përdorur metoda dhe burime bashkëkohore, vlerësimin në funksion të mbështetjes së të nxënit, mbajtjen e evidencës pedagogjike, organizimin e mbledhjeve të prindërve dhe vetëvlerësimin e punës së tyre.

2.1. Mbështetja e mësimdhënësve për planifikim, realizim dhe vetëvlerësim

- Organizimi dhe realizimi i aktiviteteve (ligjërata, trajnime/punëtori) për analizën e dokumenteve konceptuale, programeve dhe qasjeve aktuale në mësim.
- Përcjellja e mësimit dhe dhënia e informatave kthyese (me shkrim ose me gojë) mësimdhënësve.
- Vëzhgimi i cilësisë së planifikimeve për mësim dhe konsultimi me mësimdhënësit për përmirësimin e tyre.
- Ndihma e mësimdhënësve që të marrin parasysh karakteristikat individuale dhe periudhat zhvillimore gjatë planifikimit dhe realizimit.
- Realizimi i aktiviteteve për krijimin e një mjedisi stimulues për të nxënë dhe përmirësimin e klimës socio-emocionale në klasë.
- Mbështetje për vlerësim të drejtë dhe objektiv dhe për përdorimin e rezultateve të tij në planifikimet e ardhshme.
- Organizimi i takimeve informative për inovacione, punë ekipore në projekte dhe përpilim të instrumenteve për vetëvlerësim.

2.2. Mbështetja e mësimdhënësve për punë me nxënësit

- Dhënia e udhëzimeve specifike dhe mbështetjes për punë me grupe të caktuara, nxënës individualë dhe nxënës nga kategori të cenuara (në varësi të llojit dhe vështirësive specifike).
- Njohja e mësimdhënësve me stilet e ndryshme të të nxënit dhe karakteristikat e nxënësve të saporegjistruar.

- Realizimi i punëtorive për fitimin e shkathtësive komunikuese dhe përcjelljen e komunikimit në klasë.
- Ndihma e mësimdhënësit që të shohë shkaqet e sjelljes së papërshtatshme, propozimi i strategjive për tejkalim dhe përcjellja e efekteve.
- Propozimi dhe konceptimi i mënyrave për stimulimin e aftësive të veçanta të nxënësve të talentuar.

III. PUNA ME PRINDËRIT

Pedagogu i ndihmon prindërit lidhur me mënyrat për mbështetjen e fëmijëve në të nxënë, zhvillimin e potencialeve të tyre dhe edukimin në shtëpi. Theksi vihet te përfshirja e prindërve në jetën e shkollës dhe bashkëpunimi në parandalimin e dhunës mes bashkëmoshatarëve dhe kiberdhunës.

3.1. Këshillimet dhe konsultimet individuale e grupore me prindërit

- Ndarja e informacioneve për të nxënët dhe sjelljen e nxënësit në mënyrë adekuate.
- Informimi i prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore për të drejtat, detyrat dhe përfitimet e tyre, me udhëzim te institucionet relevante.
- Organizimi dhe zbatimi i këshillimeve grupore dhe individuale me prindërit, fëmijët e të cilëve ballafaqohen me dështim, parregullsi ose sjellje të papërshtatshme.
- Zbatimi i procedurës ligjore për këshillimin e prindërve/kujdestarëve (në përputhje me nenin 77 dhe nenin 78 të Ligjit për arsimin fillor):
  - Pedagogu përpilon plan javor dhe mujor për mbajtjen e këshillimit.
  - Këshillimi i prindërve/kujdestarëve kryhet detyrimisht në përputhje me Programin e vlefshëm për këshillimin e nxënësve dhe prindërve, respektivisht kujdestarëve, të përcaktuar nga ministri me propozim të Shërbimit Pedagogjik.
  - Pas përfundimit të këshillimit të prindit/kujdestarit, pedagogu realizon këshillim adekuat edhe me nxënësit, prindërit e të cilëve ishin udhëzuar në këshillim për shkak të masave ose veprimeve edukativo-disiplinore.

IV. BASHKËPUNIMI ME BASHKËSINË

Pedagogu bashkëpunon me institucione arsimore, shëndetësore, sociale, shkencore, kulturore dhe të tjera që kontribuojnë për një të nxënë më cilësor, zhvillim të nxënësve dhe zbatim të qasjeve inovative.

4.1. Bashkëpunimi me bashkësinë lokale

- Planifikimi, realizimi dhe përcjellja e aktiviteteve mes shkollës dhe bashkësisë (vizita, aktivitete mësimore dhe jashtëmësimore) për përmirësimin e arritjeve.
- Informimi i bashkësisë për nevojat dhe arritjet e shkollës.
- Përfshirja në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve parandaluese, humanitare, kulturore dhe promovimi i arsimit ndërkulturor.
- Bashkëpunimi me bashkësinë lokale gjatë ballafaqimit me situata krize (fatkeqësi, epidemi, dhunë, dukuri kriminale etj.).

V. ZHVILLIMI DHE BASHKËPUNIMI PROFESIONAL

Pedagogu ka rol kyç në përpilimin e programit për punë të mësimdhënësve fillestarë, në procesin e mentorimit të tyre, si dhe në përcjelljen e efekteve dhe mbajtjen e dokumentacionit për zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor.

5.1. Zhvillimi personal profesional

- Futja e inovacioneve në punën e vet dhe vlerësimi i efektivitetit të tyre.
- Planifikimi dhe evidencimi i zhvillimit të vet profesional dhe zbatimi i risive nga profesioni në praktikë.
- Bashkëpunimi me kolegë përmes shoqatave profesionale, rrjeteve sociale dhe forumeve.
- Mbajtja e dokumentacionit të parashikuar për zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

VI. PUNA ANALITIKO-HULUMTUESE

Pedagogu e përcjell, analizon dhe hulumton procesin edukativo-arsimor dhe, mbi bazën e njohurive të fituara, propozon masa konkrete për avancimin e mësimit dhe praktikës shkollore.

6.1. Hulumtimi i punës edukativo-arsimore

- Identifikimi i problemeve për zgjidhjen e të cilave nevojiten të dhëna hulumtuese dhe zbatimi i hulumtimeve aktuale në shkollë.
- Kryerja e përpunimit statistikor, analizës dhe interpretimit të të dhënave.
- Dhënia e propozimeve, sugjerimeve dhe hulumtimeve aksionare për rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së mësimit dhe të nxënit.

VII. STRUKTURA, ORGANIZIMI DHE KLIMA E SHKOLLËS

Pedagogu ka rol të veçantë në përcjelljen dhe avancimin e mësimit, mbajtjen e dokumentacionit pedagogjik, si dhe në mbështetjen dhe bashkëpunimin me bashkësinë e nxënësve, parlamentin shkollor, klubet dhe zhvillimin e një klime të sigurt, demokratike shkollore, të bazuar në vlerat e arsimit bashkëkohor inkluziv.

7.1. Struktura dhe organizimi i shkollës

Planifikimi, përcjellja e punës edukativo-arsimore, evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik, vlerësimi (për bashkëpunëtorin profesional – pedagog në ShFK „Liria“ – Tetovë):

- Përpilimi dhe zbatimi i instrumenteve për vetëvlerësim të shkollës.
- Nxitja, arsyetimi dhe inicimi i nismave për modernizimin e punës edukativo-arsimore.
- Përgatitja e programit zhvillimor dhe e programit vjetor për punë të shkollës.
- Vendosja e procedurave për evidencë dhe sigurimin e përfshirjes së nxënësve.
- Bashkëpunimi me organet dhe trupat profesionale në shkollë.
- Mbajtja e evidencës për punën me nxënësit dhe prindërit dhe ruajtja e saj në një vend të sigurt.
- Përcjellja e mënyrës së mbajtjes së evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik dhe propozimi i masave për përmirësim.
- Përcjellja e orëve mësimore, analiza e njohurive dhe propozimi i masave relevante për të gjithë shkollën.

PROGRAMI I PUNËS SË PEDAGOGUT SIPAS FUSHAVE TË KOMPETENCAVE

për vitin shkollor 2026–2027

I. Fusha programore: Planifikimi, programimi dhe organizimi i punës edukativo-arsimore në shkollë

Nr.	Përmbajtja programore	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
1.	Përpilimi i Programit vjetor për punën e pedagogut (duke përfshirë planet për parandalim dhe mbrojtje).	Gusht 2026	Pedagogu
2.	Pjesëmarrja në përpilimin e Programit vjetor për punën e shkollës për vitin 2026/2027.	Gusht 2026	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
3.	Përpilimi i programeve mujore (operative) për punë me përmbajtje dhe aktivitete të konkretizuara.	Vazhdimisht, në kohë	Pedagogu
4.	Formimi i paraleleve për klasë të parë.	Gusht 2026	Bashkëpunëtorët profesionalë
5.	Shpërndarja e nxënësve të sapoardhur në paralelet përkatëse.	Gusht 2026	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
6.	Njohja me nxënësit që kanë vështirësi që ndikojnë te sjellja dhe te arritja e suksesit më të dobët.	Vazhdimisht	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
7.	Ndihmë profesionale gjatë planifikimit dhe organizimit të mësimit në lëndët e detyrueshme/zgjedhore, mësimit shtesë dhe plotësues.	Vazhdimisht	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
8.	Pjesëmarrja në përpilimin e programit për punë me nxënës të talentuar dhe me dhunti.	Nëntor 2026	Bashkëpunëtorët profesionalë
9.	Përpilimi i Planit për orientim karrieror dhe profesional të nxënësve të klasës së IX-të.	Nëntor 2026	Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
10.	Përpilimi i Programit për parandalimin e dhunës seksuale ndaj fëmijëve (fushata „1 nga 5“).	Shtator / tetor 2026	Bashkëpunëtorët profesionalë, Drejtori
11.	Pjesëmarrja në përpilimin e programit për vizitë të orëve.	Nëntor 2026	Bashkëpunëtorët profesionalë
12.	Pjesëmarrja në përpilimin e programit për vëzhgim të evidencës pedagogjike.	Nëntor 2026	Pedagogu
13.	Pjesëmarrja në përpilimin e programit për punë të bashkësisë së nxënësve.	Nëntor 2026	Bashkëpunëtorët profesionalë, Nxënësit

II. Fusha programore: Përcjellja e drejtpërdrejtë e punës edukativo-arsimore në shkollë

Nr.	Përmbajtja programore	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
1.	Përcjellja e drejtpërdrejtë e realizimit të procesit mësimor përmes vizitës së orëve dhe përpilimit të protokolleve.	Vazhdimisht	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë

Nr.	Përmbajtja programore	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
2.	Përcjellja e procesit të adaptimit të nxënësve të klasës së parë.	Gjysmëvjetori I	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
3.	Përcjellja e procesit të kalimit nga mësimi klasor në atë lëndor.	Gjysmëvjetori I	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
4.	Përcjellja e punës së aktiveve profesionale dhe konsultimet me mësimdhënësit përgjegjës.	Vazhdimisht	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
5.	Përcjellja e mbajtjes së evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik në shkollë.	Vazhdimisht	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
6.	Përcjellja e suksesit dhe rregullsisë së nxënësve.	Vazhdimisht	Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
7.	Përcjellja e efektivitetit të organizimit të punës (orari i orëve, përgatitjet për mbledhje).	Vazhdimisht	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
8.	Përcjellja e realizimit të aktiviteteve të orës së klasës.	Vazhdimisht	Kujdestarët e klasave
9.	Hulumtimi, vlerësimi dhe avancimi i punës vetanake (planifikimi, dokumentimi).	Vazhdimisht	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë

III. Fusha programore: Puna këshilldhënëse-konsultative me nxënës, mësues dhe prindër

Nr.	Përmbajtja programore	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
1.	Puna instruktive-konsultative me mësimdhënësit gjatë planifikimit dhe përgatitjes së mësimit.	Gusht – shtator 2026	Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
2.	Bashkëpunimi me mësimdhënësit në zgjedhjen dhe zbatimin e formave, metodave dhe mjeteve efikase në mësim.	Vazhdimisht	Mësimdhënësit, Bashkëpunëtorët profesionalë
3.	Bashkëpunimi me mësimdhënësit nga klasa I deri në klasën III lidhur me vlerësimin përshkrues dhe socializimin.	Vazhdimisht	Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit e mësimit klasor
4.	Biseda me kujdestarët e klasave për ndërmarrjen e masave në rast të problemeve emocionale, mungesave dhe suksesit të dobët.	Vazhdimisht	Bashkëpunëtorët profesionalë, Kujdestarët e klasave
5.	Puna këshilldhënëse-konsultative me trupat profesionalë gjatë planifikimit dhe programimit.	Vazhdimisht	Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Prindërit, Drejtori
6.	Konsultimi me prindërit e nxënësve që kanë vështirësi në adaptim dhe përparim.	Gjysmëvjetori I	Bashkëpunëtorët profesionalë, Nxënësit, Prindërit
7.	Zbatimi i këshillimeve individuale dhe grupore me prindërit (neni 77 dhe 78), fëmijët e të cilëve kanë pasur dështim, parregullsi ose sjellje të papërshtatshme, të ndjekura me këshillimin e nxënësve.	Vazhdimisht	Bashkëpunëtorët profesionalë, Prindërit, Nxënësit
8.	Realizimi i punëtorive dhe edukimit për parandalimin e dhunës seksuale ndaj fëmijëve (fushata „1 nga 5“) me nxënës dhe prindër, duke përdorur materiale edukative adekuate.	Vazhdimisht (gjatë gjithë vitit shkollor)	Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Prindërit, Nxënësit
9.	Zbatimi i aktiviteteve për orientim karrieror dhe profesional të nxënësve (prezantime të profileve/drejtimeve, bashkëpunim me sektorin e biznesit dhe shkollat e mesme).	Gjatë vitit shkollor (intensivisht prill/maj)	Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Bashkëpunëtorët e jashtëm
10.	Puna këshilldhënëse me mësimdhënësit për zgjidhjen e çështjeve në relacionin nxënës–mësues–familje.	Vazhdimisht	Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Prindërit
11.	Puna konsultative me mësimdhënësit në vlerësim dhe përpilim të instrumenteve për kontroll të njohurive.	Vazhdimisht	Mësimdhënësit, Bashkëpunëtorët profesionalë
12.	Bashkëpunimi me organizatat dhe bashkësitë e nxënësve (parlamenti shkollor) për zhvillimin e vlerave demokratike.	Vazhdimisht	Mësimdhënësit, Nxënësit, Bashkëpunëtorët profesionalë
13.	Zbulimi dhe puna me nxënësit që manifestojnë sjellje të papërshtatshme (mungesa, sjellje me rrezik).	Vazhdimisht	Mësimdhënësit, Nxënësit, Prindërit, Bashkëpunëtorët profesionalë
14.	Ndihma ndaj mësimdhënësve për të siguruar që nxënësit të fitojnë përvojë për lloje të ndryshme provimesh dhe testimesh.	Vazhdimisht	Mësimdhënësit, Bashkëpunëtorët profesionalë
15.	Realizimi i takimeve individuale me nxënës dhe prindër, me pranie fizike ose online sipas nevojave.	Vazhdimisht	Bashkëpunëtorët profesionalë, Prindërit, Nxënësit

Nr.	Përmbajtja programore	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
16.	Futja krijuese e konceptit të shëndetit mendor në mësimdhënie dhe në edukimet parandaluese.	Vazhdimisht	Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit

IV. Fusha programore: Puna analitiko-hulumtuese

Nr.	Përmbajtja programore	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
1.	Përpilimi i analizës së suksesit dhe sjelljes së nxënësve pas tremujorit I dhe III.	Nëntor 2026 / prill 2027	Mësimdhënësit, Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë
2.	Përpilimi i Raportit gjysmëvjetor dhe vjetor për punën e shkollës.	Janar 2027 / qershor 2027	Drejtori, Mësimdhënësit, Bashkëpunëtorët profesionalë
3.	Puna rreth regjistrimit të fëmijëve në klasë të parë (vëzhgimi dhe biseda me prindërit).	Maj – qershor 2027	Mësimdhënësit, Bashkëpunëtorët profesionalë, Prindërit
4.	Evidentimi i shkaqeve për suksesin e pamjaftueshëm dhe mungesat e paarsyeshme te nxënësit.	Nëntor, mars, maj, qershor	Kujdestarët e klasave, Bashkëpunëtorët profesionalë
5.	Propozimi dhe realizimi i hulumtimeve aksionare për rritjen e efektivitetit të mësimit (përfshirë vlerësimet nga programet parandaluese).	Vazhdimisht	Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit

V. Fusha programore: Aftësimi profesional i kuadrit edukativo-arsimor

Nr.	Përmbajtja programore	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
1.	Pjesëmarrja në aftësimin profesional përmes aktiveve profesionale, këshillave të klasave dhe Kolegjiumit të mësimdhënësve.	Vazhdimisht	Mësimdhënësit, Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë
2.	Informimi dhe organizimi për shfrytëzim më efikas të literaturës profesionale pedagogjiko-psikologjike.	Vazhdimisht	Mësimdhënësit, Bashkëpunëtorët profesionalë
3.	Pjesëmarrja në seminare, këshillime dhe trajnime (përfshirë trajnimet për parandalimin e dhunës dhe zhvillimin e karrierës).	Vazhdimisht	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
4.	Bashkëpunimi me institucione jashtë shkollës (BZhA, MASH, DPI, Qendra për punë sociale, Shtëpia e shëndetit).	Vazhdimisht	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Prindërit
5.	Aftësimi profesional vetanak përmes përcjelljes së literaturës dhe revistave profesionale.	Vazhdimisht	Pedagogu
6.	Mbajtja dhe evidentimi i zhvillimit profesional të kuadrit edukativo-arsimor (dosje profesionale).	Vazhdimisht	Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
7.	Bashkëpunimi me Ekipin për zhvillim profesional në shkollë.	Vazhdimisht	Mësimdhënësit, Bashkëpunëtorët profesionalë

VI. Fusha programore: Mbajtja e evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik

Nr.	Përmbajtja programore	Koha e realizimit	Bashkëpunëtorët
1.	Përpilimi dhe përditësimi i dokumentacionit të parashikuar: • Programi vjetor për punën e pedagogut • Plani mujor operativ për punë • Ditari kronologjik i punës • Ditari për bashkëpunim me nxënës, prindër dhe mësues • Ditari për përcjelljen e mësimit dhe aktiviteteve jashtëmësimore • Dokumentacioni për punë analitiko-hulumtuese, punëtori të realizuara („1 nga 5“) dhe orientim karrieror	Vazhdimisht	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Prindërit, Nxënësit
2.	Mbështetja dhe vëzhgimi ndaj mësimdhënësve në mbajtjen e rregullt të evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik.	Vazhdimisht	Mësimdhënësit, Bashkëpunëtorët profesionalë

PLANI MUJOR (OPERATIV) I PUNËS SË PEDAGOGUT PËR VITIN SHKOLLOR 2026–2027

Muaji	Përmbajtja e punës	Bashkëpunëtorët
Gusht 2026	• Pjesëmarrja në përpilimin e Programit vjetor për punën e shkollës për vitin shkollor 2026–2027. • Përpilimi i Programit vjetor për punën e pedagogut. • Formimi i paraleleve për klasë të parë dhe shpërndarja e nxënësve të sapoardhur. • Puna instruktive-konsultative me mësimdhënësit për fillimin e vitit të ri shkollor.	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
Shtator 2026	• Mbështetja e mësimdhënësve në zbatimin e risive në rregullativën ligjore, rregulloret dhe udhëzimet (MASH, BZhA) lidhur me konceptin e ri. • Planifikimi i zhvillimit personal profesional. • Përcjellja e planifikimeve vjetore dhe tematike të mësimdhënësve. • Përpilimi i shtojcave ndaj Programit vjetor. • Përpilimi i orarit mujor për mësim shtesë dhe plotësues. • Vendosja e materialeve edukative dhe postereve për parandalimin e dhunës seksuale ndaj fëmijëve (fushata „1 nga 5“).	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, MASH, BZhA
Tetor 2026	• Përpilimi i programit vjetor për punën vetanake dhe i programeve të veçanta në nivel shkolle. • Përcjellja e adaptimit dhe dhënia e mbështetjes profesionale për nxënësit e klasës së I dhe të VI. • Realizimi i punëtorive fillestare edukative për parandalimin e dhunës seksuale ndaj fëmijëve („1 nga 5“). • Puna këshilldhënëse për ndërtimin e një klime pozitive socio-emocionale në klasa.	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit
Nëntor 2026	• Mbledhja e të dhënave për shkaqet e dështimit (testime, biseda, grupe fokusi). • Këshillime individuale dhe grupore me nxënës me dështim në të nxënë. • Përcjellja e suksesit, sjelljes dhe rregullsisë sipas paraleleve, lëndëve mësimore, gjinisë dhe përkatësisë etnike; përpilimi i raporteve. • Përcjellja e orëve mësimore dhe përpilimi i raporteve. • Prezantimi i analizave pas përfundimit të tremujorit të parë. • Përpilimi i Planit për orientim karrieror dhe profesional dhe i Programit për nxënës të talentuar.	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Prindërit, Nxënësit
Dhjetor 2026	• Shqyrtimi i qëndrimeve dhe përvojave të nxënësve nga klasa e I dhe e VI. • Përcjellja e përparimit të nxënësve me Plane Individuale Arsimore (PIA). • Përcjellja e përparimit të nxënësve në periudhën e parë dhe të dytë zhvillimore në shkrim-lexim. • Vazhdimi i aktiviteteve këshilldhënëse me prindërit për nxënësit me vështirësi.	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Prindërit
Janar 2027	• Mbledhja e të dhënave për shkaqet e dështimit dhe parregullsisë në fund të gjysmëvjetorit të parë. • Përcjellja dhe mbajtja e evidencës për lavdërimet, shpërblimet dhe masat edukativo-disiplinore të shqiptuara. • Prezantimi i analizave për suksesin para Këshillit të mësimdhënësve. • Pjesëmarrja në përpilimin e Raportit gjysmëvjetor për punën edukativo-arsimore të shkollës.	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Prindërit
Shkurt 2027	• Kontrolli i njohurive të nxënësve dhe bashkëpunimi me mësimdhënësit pas fillimit të gjysmëvjetorit të dytë. • Përcjellja e përparimit të nxënësve të klasës së parë (fëmijëve të vegjël). • Përcjellja e rregullsisë së nxënësve dhe ndërmarrja e masave parandaluese kundër mungesave. • Këshillime individuale me prindër.	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Prindërit
Mars 2027	• Biseda individuale dhe grupore me nxënësit për informimin dhe interesat e tyre për arsimim të mëtejshëm (orientimi karrieror). • Përcjellja e orëve mësimore. • Prezantimi i raporteve pas përfundimit të tremujorit të tretë. • Punëtori tematike për parandalimin e sjelljes së dhunshme.	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Prindërit

Muaji	Përmbajtja e punës	Bashkëpunëtorët
Prill 2027	• Dhënia e pyetësorëve dhe shkallëve të vlerësimit për orientim profesional dhe interpretimi i tyre. • Këshillimi individual dhe grupor i nxënësve për zgjedhjen e arsimit të mesëm. • Përcjellja e suksesit, sjelljes dhe rregullsisë; përpilimi i raporteve. • Përpilimi i evidencës së fëmijëve për regjistrim në klasë të parë. • Zbatimi i procedurës ligjore për këshillimin e detyrueshëm të prindërve (neni 77 dhe 78), fëmijët e të cilëve kanë vështirësi, e ndjekur me këshillimin e nxënësve. • Përcjellja e përparimit në lexim nga klasa e II deri në klasën e V.	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Prindërit
Maj 2027	• Përpilimi i analizës-raport pas hulumtimit të realizuar të qëndrimeve për orientim profesional të nxënësve të klasës së IX. • Ndihma dhe organizimi i prezantimeve të drejtimeve dhe shkollave të mesme. • Informimi i nxënësve dhe prindërve për rrjetin e shkollave të mesme. • Regjistrimi dhe testimi i fëmijëve në klasë të parë. • Vlerësimet përfundimtare të programeve parandaluese.	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Prindërit
Qershor 2027	• Shqyrtimi i qëndrimeve dhe përvojave të nxënësve për aspekte të ndryshme të të nxënit. • Përcjellja e suksesit, sjelljes dhe rregullsisë në fund të vitit shkollor; përpilimi i analizave përfundimtare. • Përcjellja dhe mbajtja e evidencës për lavdërimet dhe shpërblimet e shqiptuara. • Pjesëmarrja në përpilimin e Raportit vjetor për punën edukativo-arsimore të shkollës. • Përpilimi i raportit për punën vetanake profesionale.	Drejtori, Bashkëpunëtorët profesionalë, Mësimdhënësit, Prindërit

Përpiloi:
Bashkëpunëtor profesional – Pedagog, **Ermira Asani**